



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS

PROJEKTVENDIM

NR\_\_\_\_, DATË\_\_/\_\_/2020

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PAJTIMIT MUJOR PËR TRANSPORTIN  
QYTETAS NË BASHKINË E DURRËSIT**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, VKM-së nr. 85, datë 8.2.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, Udhëzimit Nr. 3743, Datë 10.07.2017 të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit të udhëtarëve rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 233, datë 16.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, zëvendëskryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë Durrës,

**TË VENDOSË:**

1. Miratimin e tarifave të pajtimit mujor për transportin qytetas në Bashkinë e Durrësit, si më poshtë:
  - 1.1.1 Bileta e pajtimit mujor, për një linjë 1200 (njëmijë e dyqind) lekë, (duke përfshirë dhe TVSH).
  - 1.1.2 Bileta e pajtimit mujor, të përgjithshëm për të gjithë linjat, 1600 (njëmijë e gjashtëqind) lekë, (duke përfshirë dhe TVSH).
  - 1.1.3 Bileta e pajtimit mujor për studentët 600 (gjashtëqindë) lekë.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, ”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**PËR DREJTORINË LIGJORE  
ZËVENDËSKRYETAR**

**Florian Tahiri**

**DREJTORIA SHËRBIMEVE PUBLIKE**

**Ardian Iljazaj**

**ZËVENDËSKRYETAR I BASHKISË**

**Emiriana Sako**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

## RELACION

### PËR INDEKSIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT QYTETAS NË BASHKINË E DURRËSIT

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, VKM-së nr. 85, datë 8.2.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, Udhëzimit Nr. 3743, Datë 10.07.2017 të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit të udhëtarëve rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar, VKB-së nr.590, datë 11.03.2019 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 233, datë 16.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus”, Ju paraqesim relacionin si më poshtë vijon;

Në vijim të kërkesave të vazhdueshme të subjekteve që operojnë në shërbimin e transportit publik qytetas në Bashkinë Durrës, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.590 datë 11.03.2019 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 233 datë 16.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus” është miratuar ndryshimi i pikës 1 të VKB-së nr.233 datë 16.12.2014 përsa i përket tarifës së biletës të transportit qytetas e cila ndryshon nga 30 lekë, në 40 lekë.

Gjithashtu pranë institucionit të Bashkisë Durrës janë depozituar ndër vite kërkesa nga operatorët që operojnë në linjat qytetase të qytetit të Durrësit edhe mbi rishikimin e çmimit të aboneve të transportit qytetas në Durrës.

Operatorët e shërbimit të transportit të udhëtarëve qytetas informojnë se kosto e transportit qytetas është rritur ndjeshëm për të cilën kanë sjellur argumenta financiare, kompanit janë vendosur në një vështirësi të madhe financiare prej periudhës së pandemisë COVID-19.

Ne mendojmë që këto operatorë kanë rritje të shpenzimeve në disa drejtime si:

1. Rritja e çmimit të naftës që nga 100 lek/litër që ka qenë kur kanë filluar punën sipas kontratës me Bashkinë është rritur vit pas viti duke shkuar 133 lek/litër e deri 135 lek/litër në disa raste. Duke pasur parasysh se nafta zë pjesën më të madhe të shpenzimeve.

Kjo është pasqyruar në grafikun 1 dhe 3 bashkëngjitur këtij relacioni ku tregohen si ka ndryshuar çmimi i naftës ndër vite, duke pësuar mesatarisht rritje të konsiderueshme, si dhe kosto e lëndës djegëse e shprehur në litra dhe lek, e shprehur kjo në shpenzimet e kompanisë.

2. Rritje e koston nga rritjet e nivelit të taksave si norma e tatim fitimit e cila ka ndryshuar nga 10% ne 15%.

3. Shpenzimet vjetore për paga kanë ardhur në rritje si pasojë e rritjes së numrit të personelit të kompanisë dhe rritja e vit pas viti të pagave të tyre, kjo e pasqyruar në grafikun 2 dhe në grafikun 4.
4. Njëkohësisht për të rritur performancën pozitive të shërbimit të transportit urban kompania ka investuar duke bërë blerje autobusësh të rinj, duke marrë kredi të cilat rrisin shpenzimet edhe nga interesat bankare.
5. Duke rritur flotën e autobusëve ka një rritje për shpenzime dhe mirëmbajtje të autobusëve nga amortizimi normal i përvitshëm si dhe rritje të shpenzimeve për taksa, kolaudime, siguracione, etj.
6. Nga bilancet e paraqitura nga kompanitë kemi konstatuar se janë rritur në mënyrë të ndjeshme pasagjerët me kartë invaliditeti dhe abone, gjë e cila ka sjellë rritjen e nivelit të humbjeve në bilancet e përgjithshme, shpenzime-të ardhura.  
Duke parë dhe strukturën e udhëtarëve në të cilën përqindjen më të madhe e zënë studentët të cilët pajisen me abone, si dhe femijët deri në 6 vjeç qarkullojnë pa pagesë.
7. Shqetësimet e kompanive për sa i përket numrit të madh të aboneve dhe librezave të invaliditetit të pasagjerëve që udhëtojnë janë konstatuar dhe nga kontrollet e bëra nga inspektorët e drejtorisë së shërbimeve të Bashkisë Durrës.

Referuar relacionit ekonomik – financiar duke përfshirë të gjithë komponentët e tij nëse kemi rritje të tarifës së biletës do të kemi gjithashtu dhe një rritje të tarifës së biletës së pajtimit mujor, pasi elementët të cilët ndikojnë në rritjen e tarifës së biletës janë të njëjtë me ato të cilët ndikojnë në rritjen e tarifës së biletës së pajtimit mujor.

Duke parë ankimmimet dhe kërkesat e operatorëve që nga viti 2013 të prezantuara këto me bilance mujore dhe vjetore ku aktiviteti del me humbje mendojmë që pretendimet e operatorëve privat në shërbimin e transportit të udhëtarëve qytetas janë përgjithësisht të drejta dhe të argumentuara si nga ana teknike po ashtu dhe financiare dhe propozojmë ndryshimet si më poshtë:

- Bileta e pajtimit mujor (abone) për student të qëndrojnë e njëjtë 600 lekë.
- Bileta e pajtimit mujor (abone) për një linjë, tarifa nga 900 lekë me TVSH të bëhet 1200 lekë me TVSH.
- Bileta e pajtimit mujor (abone) e përgjithshme, për të gjithë linjat, tarifa nga 1200 lekë me TVSH të bëhet 1600 lekë me TVSH.

Pra, duke qënë se me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.590 datë 11.03.2019 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 233 datë 16.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus” është miratuar vetëm ndryshimi i çmimit të biletës, mendojmë që miratimi i këtij vendimi unifikon indeksimin e tarifave të biletës vajte ose kthim me tarifë të biletave të pajtimit mujor.


Bashkëngjitur gjeni grafikët përkatës.

Duke Ju falenderuar,


**DREJTORIA E SHËRBIMEVE DHE PUNËVE PUBLIKE**  
**Ardian Iljazaj**

Koncept:Sp.Dr.Shërbimeve: K.Braho  
M.Likaxhiu


### Çmimi i naftës në vite



### Nr. i të punësuarve



### Kosto e lëndës djegëse



## Shpenzime vjetore paga

